





BULETINI MUJOR

SHKURT 2025

VEPRIMTARIA E ASPA

TRAJNIM HYRËS PËR EKSELENTËT NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE

Ka filluar trajnimi hyrës 10 ditor për ekselentët në administratën shtetërore ku do të trajtohen:

-  Njohja me misionin, strukturën dhe funksionet e administratës publike
-  Aftësitë kryesore profesionale dhe administrative
-  Zhvillimi i aftësive për menaxhim dhe performancë të lartë
-  Komunikimi Efektiv në Administratën Publike



MANUALI I RREGULLAVE TË ETIKËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE


Janë zhvilluar 2 grupe trajnimi "Manuali i rregullave të etikës në administratën publike" në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në kuadër të projektit "Forcimi i integritetit publik përmes përmirësimit të shërbimeve publike", me mbështetje nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) dhe në bashkërendim me Departamentin e Administratës Publike.



Në muajin shkurt ka vijuar trajnimi i detyrueshëm "Prezantimi me Administratën Publike" për punonjësit në periudhë prove dhe janë trajnuar 60 pjesëmarrës.



TESTIMI PËR PROKURIMIN PUBLIK

U zhvillua testimi për certifikimin e trajnimit në fushën e prokurimit publik në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, për personat përgjegjës dhe zyrtarët e strukturave të prokurimit publik. 



ZBATIMI I POLITIKAVE TË ANTIKORRUPSIONIT DHE INTEGRITETIT

U zhvillua trajnimi në klasë me temë "Zbatimi i politikave të antikorrupsionit dhe integritetit" në bashkërendim me Strategjinë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit 2023-2030 me trajnere Rovena Prega.





918

PJESËMARRËS NË TRAJNIME

323

PJESËMARRËS TË CERTIFIKUAR

16

TRAJNIME TË ZHVILLUARA

601 pjesëmarrës nga pushteti qendror

226 pjesëmarrës nga pushteti vendor

79 pjesëmarrës nga insitucionet e pavarura

12 pjesëmarrës të tjerë



Gjatë muajit shkurt u zhvillua sesioni informues “Ndërgjegjësimi ndaj inxhinierisë sociale” në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.

BASHKIMI EVROPIAN



60

PJESËMARRËS

Gjatë muajit shkurt, kemi vijuar me trajnimet në fushën e Bashkimit Evropian. Trajnimet kanë përfshirë tema të ndryshme, të cilat kontribuojnë në përmirësimin e njohurive dhe aftësive në lidhje me integrimin evropian.



3 THIRRJE PËR EKSPERTË TË SHPALLURA